



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica - Municipality of Mitrovica North

Kryetari i Komunës

Nr. _____, Data: 19.01.2024.

Mitrovicë Veriore.

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 70.19 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, në bashkëpunim dhe propozim të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, më datë 19.01.2024 merr:

V E N D I M

(Për Emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Emërimin e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës)

1. Caktohet Menaxheri i kontratës si dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **"Hartimi i Projekteve për nevojat e Komunës"** me nr: 6472312454-211, si vijon:

I: Menaxher i Kontratës caktohet z. Hamit MRIPA.

II: Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet z. Fatir BERZATI.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe emërimit të Menaxherit të Kontratës (MK) të gjitha përgjegjësitë përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit tek Menaxheri i Kontratës.

3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:

Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:

- a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë,
- b. Sigurojë se Operatori Ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë, dhe
- c. Bën vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.



Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:

- a. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri I kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi I kontratës",
- b. Menaxheri I kontratës, duhet të lexoj kushtet e kontratës dhe të përgatis Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), I cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik (OE);
- c. Të dorëzoj Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që Zyra e Prokurimit të nxjerr urdhër-blerjen;
- d. Pas pranimit të urdhër-blerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri I kontratës duhet të vendos të dhënat në platformën elektronike, të ngarkoj në platformën elektronike urdhër-blerjën dhe të përcjell të njëjtën përmes platformës tek OE, nga e cila datë fillon numërimi I afatit kohor për liferim;
- e. Të sigurojë që Operatori Ekonomik I përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f. Të sigurojë që operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- g. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues I përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë se ka kontroll adekuar të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- i. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjës së kontratës;
- j. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në system të prokurimit elektronik;
- k. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- l. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Zyrës së Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- m. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve;
- n. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Zyrës së Prokurimi dhe
- o. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate sic kërkohet nga Zyra e Prokurimit ose nga ZKA.



4. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:

- a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
- b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Erden AZH

Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore



I dorëzohet:

- 1x1 Kabinetit të Kryetarit;
- 1x1 Zyrës së Prokurimit;
- 1x1 Menaxherit të kontratës;
- 1x1 Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës
- 1x1 Arkivit